

VENDIM
Nr. 753, datë 13.12.2024

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT SHTETËROR
PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (në vijim ASIG), si person juridik publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. ASIG-u financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Misioni i ASIG-ut është krijimi, funksionimi dhe përditësimi i infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë.

4. ASIG-u organizohet dhe funksionon në përputhje me ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me përcaktimet e bëra në këtë vendim.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AUTORITETIT SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

ASIG-u ka përgjegjësi të organizojë punën, për:

a) projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen, përditësimin e kornizës referuese gjeodezike, si dhe krijimin e mirëmbajtjen e hartës bazë në Republikën e Shqipërisë;

b) mbledhjen, përpunimin, përditësimin, administrimin dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor;

c) mbledhjen, administrimin, analizimin, përpunimin e të dhënave *Remote Sensing* dhe shpërndarjen e informacionit të përpunuar;

ç) sigurimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, me qëllim bashkërendimin e veprimeve dhe nismave në fushën e informacionit gjeohapësinor.

**III. ORGANIZIMI I AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR**

1. ASIG-u e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Struktura dhe organika e ASIG-ut miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. ASIG-u drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e tij dhe përgjigjet para Kryeministrit.

4. Drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut mbështetet nga një zëvendësdrejtör.

5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve të ASIG-ut rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

6. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të ASIG-ut miratohet nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm.

7. Veprimtaria e ASIG-ut mbikëqyret nga Zëvendëskryeministri, të cilit i raportohet periodikisht çdo 3 (tre) muaj.

8. ASIG-u ka stemën, logon dhe vulën e tij zyrtare. Stema e ASIG-ut përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë dhe ka shënimet “Republika e Shqipërisë, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

9. Vula e ASIG-ut ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut realizon këto detyra:

a) drejton, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit, është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;

b) i propozon Kryeministrit miratimin e rregullores së brendshme të ASIG-ut;

c) i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave propozimin për strukturën dhe organikën e ASIG-ut;

ç) i raporton Zëvendëskryeministrit, në mënyrë periodike, çdo 3 (tre) muaj, për veprimtarinë e ASIG-ut;

d) emëron, shkarkon dhe liron punonjësit, sipas rregullave të parashikuara në dispozitat e Kodit të Punës;

dh) drejton dhe koordinon punën për hartimin dhe ndryshimin e akteve nënligjore, që dalin në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe me sektorin privat për nisma që lidhen me informacionin gjeohapësinor;

ë) organizon dhe drejton punën për hartimin dhe programimin e realizimit të objektivave vjetorë (planveprimi vjetor, projektbuxheti etj.) të ASIG-ut dhe miratimin e tyre;

f) nxjerr akte të brendshme, të detyrueshme për menaxhimin administrativ, financiar dhe burimeve njerëzore të ASIG-ut;

g) administron burimet pasurore, financiare dhe njerëzore të ASIG-ut, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DETYRAT E AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

1. Në fushën e gjeodezisë dhe hartografisë digjitale, ASIG-u kryen këto detyra:

a) ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e rrjeteve përbërëse të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për sistemin referues gjeodezik zyrtar në Republikën e Shqipërisë;

b) prodhimin e hartës bazë digjitale në Republikën e Shqipërisë në shkallë të ndryshme, në përputhje me standardet evropiane përkatëse, si autoritet kombëtar hartografik;

c) përpunimin e imazheve nga fotografimi tokësor, ajror dhe satelitor, me qëllim krijimin e informacionit gjeohapësinor;

ç) mbështetjen e autoriteteve publike përgjegjëse me ekspertizë dhe asistencë në fushën e matjeve dhe llogaritjeve gjeodezike.

2. Për mbledhjen, përpunimin, përditësimin, administrimin dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor, ASIG-u kryen këto detyra:

a) mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, të ndryshuar, për të cilat është në rolin e autoritetit publik përgjegjës;

b) hartimin e rregullave dhe standardeve teknike për GIS-in kombëtar dhe GIS-et tematike, për temat e përcaktuara nga neni 11, i ligjit nr. 72/2012, të ndryshuar;

c) hartimin dhe propozimin e kushteve dhe standardeve teknike në lidhje me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave;

ç) hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të rregullave dhe standardeve teknike për ndërveprueshmërinë e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore;

d) hartimin dhe zbatimin e rregullave në lidhje me aksesin dhe shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor nga subjektet publike dhe private;

dh) projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e GIS-it kombëtar, si dhe përfshirjen në të të dhënave gjeohapësinore dhe sistemeve tematike të informacionit gjeohapësinor;

e) projektimin, administrimin dhe përditësimin e Gjeoportalit Kombëtar, sipas përcaktimeve të nenit 24, të ligjit nr. 72/2012, të ndryshuar;

ë) shpërndarjen dhe ofrimin nëpërmjet shërbimeve të rrjetit të informacionit gjeohapësinor për subjektet publike dhe private, bazuar në rregullat për shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Për vendimmarrjen në fushën e informacionit gjeohapësinor, ASIG-u kryen këto detyra:

a) merr vendime për përcaktimin e autoriteteve publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin e përditësimin e informacionit gjeohapësinor dhe afatet e depozitimit të tij pranë ASIG-ut, sipas temave përkatëse, të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) merr vendime për nismat e autoriteteve publike përgjegjëse në fushën e gjeoinformacionit, pas marrjes së mendimit të Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (në vijim BIG);

c) merr vendime për miratimin/refuzimin e të dhënave gjeohapësinore dhe përfshirjen ose jo të tyre në GIS-in Kombëtar, pas marrjes së mendimit të BIG-ut;

ç) merr vendime për miratimin/refuzimin e sistemeve tematike të informacionit gjeografik dhe përfshirjen ose jo të tyre në GIS-in kombëtar, pas marrjes së mendimit të BIG-ut.

4. Për përpunimin e të dhënave *Remote Sensing*, ASIG-u kryen këto detyra:

a) administrimin dhe arkivimin e informacionit gjeohapësinor, të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, fotografimeve ajrore, teknologjisë UAV, skanimeve *lidar*, kamerave 360 gradë etj., të vëna në dispozicion nga Ministria e Mbrojtjes apo nga institucione në varësi të saj, si dhe të krijuara nga ASIG-u, në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj;

b) përpunimin e të dhënave *Remote Sensing* dhe analizimin e informacionit gjeohapësinor, të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, fotografimeve ajrore, teknologjisë UAV, skanimeve *lidar*, kamerave 360 gradë etj.;

c) shpërndarjen e informacionit të përpunuar nga të dhënat *Remote Sensing*, të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, fotografimeve ajrore, teknologjisë UAV, skanimeve *lidar*, kamerave 360 gradë etj., për autoritetet publike, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë;

ç) bashkëpunimin me ministritë apo institucionet për caktimin e personave përgjegjës/pikës së kontaktit, të nevojshëm për analizimin dhe përpunimin e thelluar të informacionit të marrë nga përpunimi i të dhënave *Remote Sensing*;

d) hartimin, në bashkëpunim me ministritë apo institucionet, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të manualeve dhe udhëzimeve të nevojshme për mënyrën e përdorimit të informacionit të përfutur nga përpunimi i të dhënave *Remote Sensing* me teknologji të avancuar, të cilat miratohen nga drejtori i Përgjithshëm, brenda 6 (gjashtë) muajve nga aplikimi i kësaj teknologjie;

dh) përpunimin e të dhënave nga sistemet, me qëllim prodhimin e raporteve të ndryshme, në ndihmë të grupeve të interesit, për qëllime vendimmarrjeje apo statistikore.

5. Për koordinimin ndërinstytucional dhe nismat në fushën e informacionit gjeohapësinor, ASIG-u kryen këto detyra:

a) mbështetjen e Këshillit të Ministrave për hartimin e politikës kombëtare në fushën e informacionit gjeohapësinor;

b) garantimin e zbatimit të politikës kombëtare në fushën e informacionit gjeohapësinor, bazuar në ligjin për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor dhe dokumentin e politikave për qeverisjen e sektorit të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) koordinimin e nismave për investime dhe projekte të autoriteteve publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore apo ngritjen e sistemeve të informacionit gjeohapësinor;

ç) planifikimin dhe drejtimin e projekteve me donatorë të huaj në fushën e gjeoinformacionit;

d) bashkëpunimin me botën akademike, si dhe promovimin e investimeve nga sektori privat në fushën e të dhënave gjeohapësinore;

dh) zhvillimin e trajnimeve, me qëllim rritjen e kapaciteteve të aktorëve, që krijojnë apo përdorin informacion gjeohapësinor dhe ofrimin e produkteve të kërkuara nga grupet e interesit dhe publiku;

e) ndjekjen e procedurave përkatëse në rolin e sekretariatit teknik të BIG-ut, në përputhje me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (BIG)”, të miratuar me urdhër të Kryeministrit;

ë) formulimin e kërkesave apo propozimeve për BIG-un lidhur me nismat e autoriteteve publike, përgjegjëse në fushën e gjeoinformacionit;

f) përgatitjen e rekomandimeve për autoritetet publike përgjegjëse, pas marrjes së mendimit të BIG-ut për nismat e tyre në fushën e gjeoinformacionit;

g) realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë nga sektori publik dhe privat, të lidhur me sektorin e gjeoinformacionit;

gj) përgatitjen e rekomandimeve lidhur me masat ligjore dhe organizative për ndryshimin e legjislacionit dhe përputhjen e tij me aktet komunitare;

h) përfaqësimin në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, anëtarësimi në të cilat i shërben funksionimit dhe modernizimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 147, datë 20.2.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Bordi i Informacionit Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku